



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES VERBAL

Nga mbledhja e IV-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 24.04.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:08.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të shtyhet në një nga mbledhjet e radhës së KK-së, pasi që në diskutim publik nuk kanë marrë pjesë të gjithë akterët, sepse ka shumë kërkesa nga pronarët e kombibusëve që e njëjta pikë të shtyhet dhe të diskutohet më gjerësisht për të. Po ashtu kerkoi që pika nr. 15 e rendit të ditës të hiqet, pasi që për dy propozimet e para nuk ka planifikim buxhetor. Gjithashtu propozoi që në rend dite në “të ndryshme” të futen këto pika:

- Shqyrtimi i petitionit të qytetarëve.
- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i AAK-së pajtohet me propozimet e bëra nga kryesuesi i kuvendit, lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e rendit të ditës. Pastaj lidhur me dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet, kerkoi që të formohen komisionet për çështjet në fjalë, si dhe për mbledhjen e ardhshme të KK-së të sillet informata lidhur me dëmet e shkaktuara nga vërshimet dhe propozimet për masat konkrete për sanimin e atyre dëmeve.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i LDK-së pajtohet me propozimet e bëra nga kryesuesi i kuvendit, lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e

rendit të ditës. Po ashtu kërroi që për mbledhjen tjetër të KK-së të përgatitet informata lidhur me dëmet e shkaktuara nga vërvshimet. Mandej tha se Grupi kuvendar i LDK-së propozoi që të hiqet nga rendi i ditës edhe pika nr. 16, pasi që është e propozuar nga autoriteti jokompetent, dhe e njëjtë nuk është shqyrtuar në KPF, dhe kështu duke iu referuar arsyetimit për këtë propozim-vendim, e porositi qeverinë lokale që të bëjë kursime në sektorët tjerë, e jo në punën dhe cilësinë e Kuvendit të komunës, duke shtuar se sigurimi i materialit në kopje fizike për anëtarët e kuvendit nuk është ngarkesë për buxhetin e komunës, ndërsa lidhur me propozim-vendimin për "të ndryshme", tha se Grupi kuvendar i LDK-së pajtohet, edhe pse është befasuese që i njëjti nuk ka kaluar përmes KPF-së, kur dihet se bëhet fjalë për një turnir tradicional.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - kërroi informatë nga kryetari i komunës lidhur me rrënimin dhe ndërtimin e kiosqeve, përballë Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina".

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit - propozoi që në "të ndryshme" të futet formimi i komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërvshimet në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, tha se vërvshimet kanë shkaktuar dëme në bujqësi dhe në objekte të banimit, si dhe në objekte tjera përcjellëse, duke shtuar se ekzekutivi ka qenë në gjendje gatishmërie, ku në shumë raste është intervenuar për të shmangur dëmet e mëdha. Po ashtu njoftoi se komisionet që u kërkuau nga anëtarët e kuvendit, të njëjtat janë themeluar me kohë. Pastaj tha se nuk është në rregull që ekzekutivi i komunës t'i pajisë anëtarët e kuvendit me laptop, dhe në të njëjtën kohë t'ua dérgojë të gjithë anëtarëve të kuvendit materialin e mbledhjeve të KK-së në kopje fizike, duke propozuar që ata anëtarë të kuvendit që dëshirojnë materialin në kopje fizike, duhet t'i kthejnë (dorëzojnë) llaptopët. Në fund tha se projekti e parashevë që të hiqen kiosket përballë Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina", duke shtuar se e njëjta hapësirë ka nevojë për një ndërtim të ri të kiosqeve.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – lidhur me dërgimin e materialeve, kërroi që materialet për mbledhjet e KK-së të dërgohen në kopje fizike, derisa të hyjmë në objektin e ri të komunës, po ashtu kërroi që materialet e njëjta të dërgohen nëpër selitë e partisë për të gjithë anëtarët e kuvendit.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për Qendrën kryesore të mjekësisë familjare (shqyrtimi i parë).
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare.
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me pagesën e qirasë për familjet me gjendje të rëndë sociale.
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar, shkurt, mars 2014.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimeve për ndryshimin dhe plotësimin e:
 - a. Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.
 - b. Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.
 - c. Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndarjen e bursave për vitin 2013.
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen fizike të objekteve shkollore.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës - tokës bujqësore dhe kullosove.
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Ambientit.
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për revidimin e Planit Zhvillimor Komunal në Komunën e Vushtrrisë.
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Planit për Zonën e Vjetër të Qytetit të Vushtrrisë.
14. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i petucionit të qytetarëve.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.
 - c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet unanimisht procesverbalit në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për Qendrën kryesore të mjekësisë familjare (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Statuti për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 25.04.2014 dhe zgjatë deri më 20.05.2014.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim pjesa e mbetur e mjeteve financiare në vlerë prej 8.281,10 € nga kodi i projektit 90260 për ndërtimin e ambulancës në fshatin Duboc në vlerë prej 4.191,5 €, si dhe pjesa e mbetur nga mjetet financiare nga kodi i projektit 90259 për ndërtimin e ambulancës në fshatin Samadrexhë në vlerë prej 4.089,55 € ridestinohen në projektin e ri "instalim i kabllit elektrik dhe pjesëve fazonike" në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me pagesën e qirasë për familjet me gjendje të rëndë sociale.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se në informatën në fjalë mungon e dhëna se nga cilat vende vijnë familjet e përmendura në këtë informatë, si dhe kërkoi sqarime pasi që janë katër familje shfrytëzuese që kanë mbiemrin e njëjtë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është dashtë të ceket numri i muajve për secilën familje, sa ka paguar komuna qira për to.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - kërkoi që informata në fjalë të plotësohet konform kërkesave të anëtarëve të kuvendit.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar, shkurt, mars 2014.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, në faqe nr.1, te "përbledhja e të hyrave komunale", te "të hyrat vetanake", tha se është për t'u përgjëzuar DBF-ja nëse janë shifrat e sakta në mes të buxhetit të planifikuar dhe të hyrave të realizuara. Pastaj tha se është interesant që prokurimi nuk ka planifikuar asnjë cent të hyrë për këtë periudhë tremujore të raportimit, kurse në vitin e kaluar për të njëjtën periudhë janë inkasuar 7,895.53 €. Te "qiraja për tokë bujqësore" shihet se janë inkasuar 108 %, por shtoi se nuk mund të inkasohet më shumë sesa që është e paraparë në kontratë. Mandjej te "përbledhja e shpenzimeve sipas drejtive" tek Urbanizmi thuhet se për periudhën raportuese janë paraparë 2,427,614.13 €, kurse janë realizuar 109,790.30 €, ku është tejkaluar për 452 %, prandaj diçka nuk është në rregull. Në fund lidhur me shpenzimet për hartim të projekteve për planifikim dhe urbanizëm, ku për këtë periudhë raportuese janë shpenzuar 17,681.86 €, kërkoi sqarime për çfarë projekte të hartuara bëhet fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se informata në fjalë e përgatitur vetëm në shifra, pa ndonjë tekst, është e cekët, pasi që nevojitet një pasus për të treguar se çka e karakterizon komunën, si dhe cilat masa janë ndërmarrë për realizimin e përgjithshëm të të hyrave të komunës për këtë periudhë tremujore. Po ashtu është e nevojshme të informohemi se cilat të hyra, për cilat vite janë realizuar, pasi që janë mbi 2 milionë euro të hyra të painkasuara nga vitet paraprake, prandaj është e domosdoshme që të informohemi se a janë rritur apo zvogëluar ato obligime. Pastaj tha se duhet të informohemi se cilat janë arsyet e rënies së donacioneve. Gjithashtu është e nevojshme që të informohemi rrëth planifikimit dhe shpenzimit të shumës prej 10.000 € në stacionin e autobusëve në këtë kohë, kur statusi i këtij stacioni është specifik. Në fund tha se për shkak të planifikimit komunal të investimeve në territorin e komunës, mund të kemi informatë për të hyrat vetanake, sidomos tatimit në pronë, sipas vendbanimeve që janë në territorin e komunës, sepse prioritetet përcaktohen dhe kthimi i atyre tatimeve qytetarëve iu bëhet nëpërmes projekteve kapitale, të cilat e përmirësojnë jetën e tyre, pasi që anëtarët e kuvendit që sa kohë nuk kanë informatë se nga cilat lokalitete realizohet tatimi në pronë, prandaj informata në fjalë duhet të plotësohet me të dhëna shtesë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë, si dhe lidhur me pyetjet dhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit për këtë informatë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - kërkoi informatë sesa është zvogëluar borxhi nga të hyrat e painkasuara nga vitet paraprake, që janë mbi 2 milionë euro, sa janë të hyrat, si dhe sa janë realizuar ato sipas lokaliteteve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë, si dhe lidhur me diskutimet e anëtarëve të kuvendit për këtë informatë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimeve për ndryshimin dhe plotësimin e:

- Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.
- Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.
- Rregullores për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-rregulloreve në fjalë, tha se Drejtoria për Arsim, ka propozuar që të inkorporohen vetëm udhëzimet e reja administrative, prandaj propozoi që këto draft-rregullore të procedohen me nene të plota për mbledhjen tjetër të kuvendit. Po ashtu tha se me këto rregullore duhet të

keqardhje që shkollat e reja, si rezultat i kualitetit të dobët të kenë myk, siç është rasti i shkollës së re tek policia.

Shaban Beka, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, kërroi që të ketë kujdes më të madh lidhur me kualitetin e ndërtimeve të objekteve shkollore. Pastaj tha se gjatë kontaktit me drejtorin e shkollës në Novolan, është paraqitur gjendja alarmante për mungesën e dyerve për tualetin e shkollës në fjalë, prandaj kërroi që kjo çështje të rregullohet.

Habib Musfata, anëtar i kuvendit - tha se Drejtoria për Arsim ka paraqitur një informatë reale për gjendjen fizike të objekteve shkollore në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - pyeti lidhur me gjendjen fizike të Shkollës së Mesme të Ulët II, pasi që në një emision televiziv gjendja e kësaj shkolle paraqitet me shumë probleme dhe krejt ndryshe nga gjendja që është paraqitur në informatën në fjalë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - e përgëzoi Drejtorinë për Arsim për përgatitjen e informatës për gjendjen fizike të objekteve shkollore. Po ashtu propozoi që në rregulloret e shkollave të inkorporohen përgjegjësi shtesë për drejtorët e shkollave lidhur edhe me mirëmbajtjen e shkollave.

Musaj Tërbunja, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me diskutimet e anëtarëve të kuvendit për informatën në fjalë.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës - tokës bujqësore dhe kullosove.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, e cakton edhe afatin kohor, e që një afat i tillë mungon në propozim-vendimin në fjalë, prandaj në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që këto toka të jepen në shfrytëzim për 5 vite.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se këtu do të ketë punë edhe prokuroria dhe organet gjegjëse, pasi që të gjitha parcelat e propozuara janë duke u shfrytëzuar, prandaj është dashtë të merret një vendim për ata që shfrytëzojnë parcelat e komunës dhe që nuk kanë paguar qiranë. Po ashtu kërroi formimin e një komisioni për vlerësimin e parcelave në fjalë, sepse përndryshe do të krijojen konflikte në mes të qytetarëve dhe përgjegjësia do të bie mbi anëtarët e kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - sqaroi se nuk është e arsyeshme që të përcaktohen 5 vite për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës, pasi që nëse dikush është i interesuar për të mbjellë pemë, nuk ka leverdi të aplikojë për 5 vite shfrytëzim, prandaj propozoi që në bazë të kritereve të përcaktuara nga komuna, të caktohen edhe vitet e dhënies në shfrytëzim.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, pyeti se ku janë këto prona, në cilën pjesë të territorit të komunës gjenden, si dhe sa sipërfaqe janë prona bujqësore që janë nën kompetencën e komunës. Po ashtu kërroi që të ketë shumë kujdes gjatë ndarjes së pronave, duke iu dhënë pronat në shfrytëzim atyre që merren me bujqësi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me propozim-vendimin në fjalë dhe diskutimet e anëtarëve të kuvendit për këtë propozim-vendim, sqaroi se nëse ka ndonjë tokë që është punuar dhe nuk ka kontratë, atëherë bëhet fjalë për usurpim, prandaj është obligim i drejtorisë përkatëse për të formuar komision për verifikimin e gjendjes në terren dhe nëse vërtetohet se ka usurpim, duhet të ngrihet padi ndaj usurpuesit, duke shtuar se nuk duhet të shpallet tender për toka që nuk janë të lira.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:
Me këtë vendim lejohet dhënia me qira e të gjitha tokave bujqësore dhe kullosave në pronësi të Komunës së Vushtrrisë, të konstatuara nga organet gjegjëse.
Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim do të rregullohen me kontratë të veçantë konform dispozitave ligjore në fuqi.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit Konsultativ për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Ambientit.

Bahrije Pllana, anëtar e kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se rekomandimi i parë me të tretin janë në kundërshtim, duke e përkrahur rekomandimin e tretë për heqjen e kontejnerëve, pasi që vetveti po krijohen deponi të mbeturinave, dhe në vend të kontejnerëve të zbatohet propozimi për qese të plastikës. Pastaj tha se edhe në mbledhjen paraprake kemi propozuar që kompania "Uniteti" të bëhet kompani komunale, prandaj kërkoi që edhe kjo çështje të jetë rekomandim i komitetit përkatës. Në fund tha se komiteti në fjalë duhet t'i rekomandojë drejtorisë përkatëse, dhe në të njëjtën kohë të informohemi se sa prej rekomandimeve nga ky komitet janë implementuar.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për revidimin e Planit Zhvillimor Komunal në Komunën e Vushtrrisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i LDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë, por paraprakisht kërkoi sqarime se sa përqindështë zbatuar plani zhvillimor komunal, i cili është hartuar me 12.06.2009. Në fund propozoi që te neni i propozim-vendimit në fjalë të shtohet fjalia "...lejohet revidimi...".

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që së pari të sqarohet se a bëhet fjalë për hartimin e ri të térësishëm të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban apo revidimi i planit ekzistues zhvillimor, pasi që titulli dhe arsyetimi i propozim-vendimit në fjalë nuk përputherford mes vete. Pastaj tha se procesi i hartimit të planit zhvillimor duhet të jetë proces gjithëpërfshirës, duke i përfshirë në grupet punuese të gjitha grupet e interesit, si: pronarët e tokave, komunitetin e biznesit, komunitetin fetar, konkretisht Këshillin e Bashkësisë Islame të Vushtrrisë, si përfaqësues i bashkësisë më të madhe fetare në komunë, i cili në vazhdimësi paraqet kërkesa përzgjerim të infrastrukturës dhe si pasojë e mospërfshirjes në proces të planifikimit, përballet me pengesa të ndryshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar pyetjes së I.Gashit, tha se është e vështirë të përcaktohet me përqindje shkalla e zbatimit të Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Vushtrrisë, duke shtuar se qyteti i Vushtrrisë e ka një gjendje më të mirë, falë Planit zhvillimor urban të deritanishëm.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke e sqaruar kërkësën e vet lidhur me nivelin e përqindjes së zbatimit të planit në fjalë, tha se interesimi i tij lidhet me faktin se revidimi i planit në fjalë mund të realizohet me mjete sa më të vogla financiare të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet revidimi i Planit Zhvillimor Komunal 2009-2014, i cili përfshin Planin për Zhvillimin e Zonave Urbane dhe Rurale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Plani Zhvillimor Komunal përfshin periudhën kohore 2014-2022 me mundësi vazhdimi.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Planit për Zonën e Vjetër të Qytetit të Vushtrrisë.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se plani në fjalë është paksa i vonuar, sepse veprimet e deritanishme në këtë zonë kanë shkaktuar dëme të pakthyeshme në aspektin vizuel dhe të funksionimit të kësaj zone. Pastaj propozoi që në kuadër të listës së monumenteve të qytetit të përfshihet edhe xhamia e "Gazi Ali Beut", e cila është e të njëjtës periudhë sikurse Hamami dhe është njëra ndër xhamitë më të vjetra në Ballkan. Po ashtu propozoi që shtëpitë e mbeturat qytetare të arkitekturës tradicionale shqiptare, të rivitalizohen dhe të vendoset një lidhje organike mes tyre, përmes një plani detaj, i cili do të pasojë planin për konversim.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - tha se propozim-vendimi në fjalë është shumë i vonuar, pasi që qyteti i Vushtrrisë ka pas nevojë për një plan të tillë që nga paslufta. Pastaj tha se Vushtrria është qyteti më i vjetër në Kosovë, por asgjë nuk ka mbetur nga lashtësia e tij, dhe për këtë fajtor janë qeveritë e mëparshme të pasluftës. Po ashtu tha se është e nevojshme që të konservohen vetëm tri monumente: Hamami, Kalaja dhe Ura e Gurit, duke shtuar se renovimi që po bëhet në Hamam nuk është duke u bërë në mënyrë profesionale. Në vazhdim njoftoi për projektin e TIKA-s lidhur me restaurimin e Hamamit, por që i njëjti nuk ka arritur të implementohet, pasi që Ministria e Kulturës në vend të TIKA-s ka përzgjedhur CHWB-në.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - propozoi që në nenin 1 të propozim-vendimit në fjalë të shtohet fjalia "...do të përfshihen vetëm....".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota "për", 1 "kundër", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet hartimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën e Vjetër të qytetit në Komunën e Vushtrrisë. Në këtë plan do të përfshihen vetëm objektet e karakterit të trashëgimisë kulturore dhe historike.

14. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i peticionit të qytetarëve.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - duke iu referuar peticionit në fjalë, tha se kërkesa e familjes Haziri është e përcjellur meakuza të ndryshme të pabaza dhe e paargumentuar, përderisa Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri ka argumentuar në mënyrë rationale dhe reale punën e imamit të xhamisë dhe xhematit të asaj xhamie, duke dëshmuar se është në gjendje t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i shmangur të gjitha problemet e mundshme, duke ndërmarrë masa konkrete, siç janë: ndalja e ezanit (që të mos dëgjohet ezani jashtë xhamisë), ndaljen e mësim-besimit, vetëm për të ruajtur vlerat më të mira të mirëkuptimit të ndërsjellë në mes të qytetarëve dhe për të evituar brengat e kësaj familjeje. Pastaj tha se të gjitha këto masa të ndërmarra nga Këshilli i Bashkësisë Islame, dëshmojnë se ky komunitet fetar është pro respektimit të ligjit dhe se të gjitha aktivitetet në atë xhami janë në përpjthje me rregulloret e Bashkësisë Islame dhe kurrsesi nuk lejon aktivitete që cenojnë rendin publik të qytetarëve, siç ka akuzuar pala ankuese. Po ashtu përmendi faktin se numri i të deklaruarve përmes peticionit drejtuar organeve komunale pro ndërtimit të xhamisë në atë vend, arrin në 170 nënshkrime, kurse për këtë peticion për ndalimin e aktivitetave në këtë xhami janë deklaruar 24 persona të familjes Haziri, prandaj më me interes do të ishte të diskutohej për dhënen e lejes së ndërtimit të asaj xhamie, sesa çështjen që e kanë ngritur në këtë

peticion. Në fund i propozoi Kuvendit të komunës që ta hedhë poshtë peticionin e familjes Haziri si të pabazuar dhe të paargumentuar.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar peticionit në fjalë, tha se Grupi kuvendar i LDK-së propozon që kryetari i komunës së bashku me komunitetin, Këshillin e Bashkësisë Islame, të diskutojnë për të arritur një kompromis dhe nëse nuk arrihet kompromisi, atëherë duhet të respektohet ligji.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - lidhur me peticionin në fjalë, tha se kërkesa e qytetarëve duhet të trajtohet, edhe pse nuk është kompetencë e Kuvendit të komunës për të marrë vendim, mirëpo pas trajtimit nga Kuvendi, mund të jepen rekomandime për drejtoritë kompetente për të gjetur një mirëkuptim të përbashkët për të gjitha palët. **Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - tha se Grupi kuvendar i AAK-së pajtohet me parafolësit, pasi që është përgjegjësi e kryetarit të komunës që së bashku me palët e përfshira të arrihet një marrëveshje adekuate.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - lidhur me peticionin në fjalë propozoi që përveç kryetarit të komunës, pjesë e ekpitit për negociata të jenë edhe anëtarë të kuvendit. Pastaj tha se ajo lagje ka nevojë për një xhami, duke shtuar se rruga për në atë xhami ishte mjaft e gjërë, duke shtuar se duhet të lejohet ndërtimi i xhamisë në atë vend.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me peticionin në fjalë, njoftoi se në cilësinë e kryetarit të komunës ka biseduar me përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame dhe me përfaqësuesit e komunitetit, mirëpo nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët. Pastaj tha se Këshilli i Bashkësisë Islame ka qenë korrekt, pasi që ka shprehur gatishmëri për dialog për çdo çështje që i intereson komunitetit, në mënyrë që të arrihet një kompromis. Në fund propozoi që përveç kryetarit të komunës, pjesë e ekpitit për të biseduar me palët në një takim të veçantë të jetë edhe nga një përfaqësues i subjekteve politike i Kuvendit të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Formohet ekipi (përveç kryetarit të komunës) nga Kuvendi i komunës me këtë përbërje: Ali Januzi, Ilmi Azemi, Agim Bregaj, Mentor Ferizi, Ermal Lahu dhe Ergin Sunguri, për të dialoguar me palët e përfshira në mosmarrëveshje me qëllim të arritjes së një kompromisi.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - e përkrahu propozim-vendimin në fjalë, por kërkoi që herave tjera të planifikohet me kohë ky aktivitet kulturor.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, propozoi që t'ju ndahet shuma prej 2.000 € për organizimin e këtij turniri.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që t'ju ndahet shuma prej 1.400 €, ashtu siç ka qenë e parashtruar kërkesa nga organizatori i turnirit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale prej 29,375.00 € të shfrytëzohet shuma prej 1,400.00 € (një mijë e katërqind euro) për aktivitetin sportiv “Studimja 99”, të organizuar nga Klubi i Shahut “Llamkos” nga Vushtrria.

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - lidhur me përgjigjen që ka marrë për pyetjen që ka bërë lidhur me dy konkurse te fundit, tha se ka shprehur shqetësimin që po shpalen konkurse dhe të njëjtë po keqpërdoren, po ashtu bëhen transfere të brendshme për akomodimin e njerëzve të partisë në pushtet.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sqaroi se transferet bëhen vetëm në rastet kur është e nevojshme për një funksionim më të mirë të institucioneve, duke shtuar se transferet e tilla realizohen në përputhje të plotë me ligjin, kurse qëllimi i konkurseve është përzgjedhja e kandidatëve më të përgatitur profesionalisht.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se një kërkesë që ka ardhur nga banorët e fshatit Pasomë, për largimin e një deponie të mbeturinave në një parcelë që është pronë komunale, në këtë rast pyeti se kur do të merren masat konkrete për largimin e deponisë në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se pas shqyrtimit të kërkesës së banorëve të fshatit Pasomë, lidhur me atë deponi të mbeturinave, ka formuar komision për verifikimin e gjendjes. Po ashtu tha se qeveria lokale është duke punuar për të caktuar një lokacion të vecantë për hedhjen e mbeturinave të ngurta.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - pyeti drejtoreshën e DKRS-së lidhur me çështjen e Kalasë, pasi që dje është hequr dera e vjetër e saj, dhe përfillet se brenda Kalasë do të hapet një lokal afarist, prandaj në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi informatë se çka është duke u punuar brenda Kalasë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sqaroi se dera e vjetër e Kalasë është derë e vonshme, pasi që në të kaluarën Kalaja nuk ka pas derë fare.

Enes Toska, përfaqësues i CHWB-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me restaurimin dhe konservimin e Kalasë së qytetit të Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - paraqiti shqetësimin se në parcelën në fshatin Pasomë ku po hedhen mbeturinat e ngurta, është krijuar një pamje shumë e keqe, duke shtuar se në vitet e mëhershme Kooperativa Bujqësore, të njëjtën parcelë e ka shfrytëzuar për të mbjellë kultura të ndryshme bujqësore, prandaj kërkoi nga ekzekutivi që të ndërmerren masa sa më shpejt, për eliminimin e asaj deponie të mbeturinave të ngurta, si dhe kërkoi nga komuna që të caktohet një lokacion adekuat për hedhjen e mbeturinave të ngurta, duke shtuar se lokacioni i përfolur në fshatin Pestovë nuk është adekuat për një gjë të tillë. Pastaj tha se është një shtëpi në thellësi të fshatit Kurillovë, ku banon Jakup Muzaqi, i cili gjatë luftës ka kontribuar shumë duke dhruuar patate dhe gjëra tjera ushqimore dhe i njëjti kërkon që të ndërtohet rruga në relacionin Kurillovë-Sllakoc, prandaj kërkoi nga komuna që të njëjtit t'i realizohet kërkesa. Mandej tha se disa banorë të fshatit Skoqne kanë pyetur se a do të hapet ndonjë rrugë në këtë fshat dhe nëse po, kur do të ndodhë. Në fund lidhur me restaurimin e Kullës së Zejnalla Begut në fshatin Balinc, pyeti se a po e restauron komuna apo ministria.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime lidhur me lokacionin në fshatin Pestovë për hedhjen e mbeturinave të ngurta. Pastaj tha se për vitin e ardhshëm komuna duhet të ndajë mjete për të ndërtuar një rrugë e cila lidh fshatrat: Bozhan, Vesekoc dhe Kurillovë, e nëse shtëpia e përmendur nga A.Januzi nuk mund të lidhet në këtë rrugë, atëherë duhet t'i bëhet zgjidhje përmes ndërtimit të një rruge të rendit të IV-të, dhe për momentin do të nderohet rrugë e rendit të IV-të edhe në fshatin Skoqne. Në fund sqaroi se shtatë komuna kanë marrëveshje me CHWB-në për evidentimin dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi, CHWB-ja është duke e restauruar edhe Kullën e Zejnalla Begut.

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit - tha se vitin e kaluar ishte një projekt për realizimin e shërbimeve komunale në fshatin Prelluzhë, por projektin në fjalë ka dështuar, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që ta formojë urgjentisht një komision për të na ndihmuar në këtë drejtim. Po ashtu kërkoi që të eliminohen mbeturinat e hedhura në lumin që kalon në periferi të fshatit Prelluzhë, dhe kërkoi që Drejtoria për Inspektime të ndalojë

hedhjen e mbeturinave në lumenj, nga banorët e fshatit Prelluzhë. Në fund paraqiti edhe një problem që kanë me komunitetin rom, lidhur me shfrytëzimin e sallës së sporteve në Prelluzhë, ku kerkoi që e njëjtë të largohet nga ai lokacion.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - njoftoi se Komuna e Vushtrrisë përmes kompanisë "Uniteti" ka provuar të bëjë marrëveshje me komunitetin serb në fshatin Prelluzhë për t'ua larguar mbeturinat, por nuk kanë mundur të arrijnë marrëveshje për çështjen në fjalë, duke shtuar se përsëri do të bëjmë përpjekje për të arritur marrëveshje. Në fund tha se sallën e sporteve mund ta largojë komuna, edhe pse komuna nuk e ka ndërtuar dhe nuk ka bërë pranimin teknik të saj.

Melihate Basholli, anëtar e kuvendit - propozoi që në datat: 2, 22 maj, si dhe 1 shtator të mos punohet, ose gjatë orëve të shënimit të akademive përkujtimore, të ndërpritet puna dhe t'i përkushtohemi akademive përkujtimore, si dhe të kemi mundësi që të gjithë të jemi pjesëmarrës në këto akademi përkujtimore në shenjë respekti për dëshmorët, martirët dhe për të rënët tjerë.

Bahrije Pllana, anëtar e kuvendit - propozoi që mjetet prej 10.000 € që ishin të destinuara për stacionin e autobusëve, të bartën në realizimin e projektit për kontrollin sistematik të nxënësve, pasi që ky projekt në mandatin e kaluar ka mbetur i parealizuar në mungesë të mjeteve financiare. Mandej kerkoi nga kryesuesi i kuvendit dhe nga kryetari i komunës, si dhe nga delegatët e Asociacionit të Komunave për ta sensibilizuar çështjen e kompensimit të delegatëve, pasi që kompensimi aktual është nënçmues krahasuar me punën që e bëjnë anëtarët e kuvendit. Në fund dha vërejtje për drejtoret e qeverisë lokale që nuk po qëndrojnë në sallën e kuvendit derisa të përfundojnë punimet e mbledhjes së KK-së.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së ka kerkuar informatë me shkrim nga kryetari i komunës lidhur me bizneset që kanë borxh të tatimit në pronë mbi 100 €, por pasi që informata e tillë nuk i ka ardhur, përsëri e kerkoi atë informatë për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - njoftoi për realizimin e disa aktiviteteve kulturore në rastin e shënimit të <<Ditës së Turqve të Kosovës>>. Pastaj kerkoi nga kryetari i komunës që edhe komuniteti turk ta ketë përfaqësuesin e tyre në Zyrën për Kthim dhe Komunitete. Në fund ngriti shqetësimin se po përfillet që në Komunën e Vushtrrisë me dy dëshmitarë po iu mundësohet ndërrimi i përkatësisë etnike.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - paraqiti një shqetësim të qytetarëve lidhur me shërbimet e noterisë në Komunën e Vushtrrisë, pasi që Vushtrria me 70.000 banorë ka vetëm një noter, dhe në këtë rast po krijohen pritje të gjata për rregullimin e dokumentacionit, duke shtuar se noteri duhet të jetë nga Vushtrria.


Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me kërkesën e E. Sungurit, për angazhimin e një përfaqësuesi nga komuniteti turk, në Zyrën për Kthim dhe Komunitete, tha se do të veprohet në përputhje të plotë me ligjin.

Fatime Haziri, anëtar e kuvendit - pyeti kryetarin e komunës se në bazë të të cilave kritere është ndryshuar përbërja e delegacionit i cili do të udhëtojë për Suedi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sqaroi se përbërja e delegacionit është ndryshuar me kërkesën e suedezevë

Mbledhja përfundoi në orën 14:25.

Procesmbajtësi


Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhagrova

